



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.814 /2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së nr.02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane neni 1 dhe 5, Rregulloren për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit 01/Nr.9274/2019 neni 4, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022 merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit.
2. Komisioni përbëhet prej 7 (shtatë) nga të cilët , 4 (katër) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjekte të ndryshme politike, 1 (një) anëtar nga ekzekutivi, 1 (një) nga shoqëria civile dhe 1 (një) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.
 - 2.1.Xhevahir Dernjani - PDK
 - 2.2. Sherif Berisha – LVV.
 - 2.3. Refet Kalisi - LDK-së.
 - 2.4. Zaim Bela – AAK.
 - 2.5. Natyra Kalisi - nga Ekzekutivi i Komunës.
 - 2.6. Visar Hasallari – nga Shoqëria Civile.
 - 2.7. Përfaqësuesi i fshatit përkatës.
3. Komisioni i themeluar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 7 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale.
 - 3.1. Përmes shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhen këshillat lokale:-
 - 3.1.1. Mediave lokale;
 - 3.1.2. Vebfaqes zyrtare të komunës.
 - 3.1.3. Rrjeteve sociale.
 - 3.2. Njoftimi i publikut duhet të përmbajë:-
 - 3.2.1 Rendin e ditës;
 - 3.2.2 Datën;
 - 3.2.3 Kohën;
 - 3.2.4 Vendin e mbajtjes së tubimit

4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komisionit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 28.02.2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 849 /2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 12 shkronja (d), 40, Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012-MPB-032012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi neni 9 paragrafi 1.7, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR
VITIN 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022 për komunën e Hanit të Elezit.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi,
- Ministria e Punëve të Brendshme,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.02.2022





01/ Nr. 851/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 11 pika 3, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 55, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIVE PËR
PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR VITIN 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës për komitetin konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për vitin 2022 për mbledhjet që do të mbahen për komitetin konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Komiteti Konsultative,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28. 02. 2022

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 850/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 55, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komiteti për Komunitete,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28. 02. 2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 866/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINACIAR PËR VITIN 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin financiar për vitin 2021.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i financiar për vitin 2021 i hartuar nga drejtoria për buxhet dhe financa.
3. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë për vitin 2021 është në lartësi prej 2,520,165.91€, ndërsa ai përfundimtar është 2,686,554.11 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-dhjetor 2021 është në shumë prej 2,634,463.47€ apo 98.06 %. Prej tyre për Paga dhe shtesa janë shpenzuar 1,645,045.11€ apo 99.55 %, mallra dhe shërbime 348,741.08 € apo 98.75 %, shpenzime komunale 64,899.87 € apo 96.87 %, subvencione dhe transfere 72,465.00 € apo 90.25 % dhe shpenzime kapitale 503,312.41 € apo 88.05 %.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.02.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 848/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d) , Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2022 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.02.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

